



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME TEKNIKE EKONOMIKE TIRANE

Nr. 895 Prot.

Tiranë, më 4/11/2022

Lënda: Njoftim për vend të lirë

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 14, datë 27.5.2021, Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimit të Ofruesve Publikë të Arsimit dhe Formimit Profesional, Neni 11, pika "b" shkolla Teknike Ekonomike Tiranë ju njoftim krijimin e vendit të lirë për vitin shkollor 2022-2023 në pozicionet:

- 1. (një) mësimdhënës të kulturës profesionale (teori dhe praktikë profesionale) me kohë të pjesshme në drejtimin *Ekonomi – Biznes*.
- 2. (pesë) mësimdhënës të kulturës profesionale (teori dhe praktikë profesionale) me kohë të pjesshme në drejtimin *Tekstil – Konfeksion* (diplomuar në Inzhinieri Tekstil ose Dizajn mode), që do të mbulojnë ngarkesën mësimore në nivelin pas të mesëm.

1. Kriteret e marrjes në punë:

1.1 Kriteret të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryjë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të forcës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

1.2 Kriteret të posaçme për personelin mësimdhënës të teorisë profesionale të ofruesit të AFP-së, që ofrojnë arsim të mesëm profesional.

- a) të ketë diplomë të nivelit master profesional ose të barabartësive, në të njëjtën fushë me njërin nga kualifikimet profesionale të ofruesit të AFP-së;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vit përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

2. Dokumentet e aplikimit:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;

Adresa :
Rruga "Nëhoji Martini", Tiranë
Tel: 42213310



Email:
teknikeekonomike@nsh.gov.al

- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatë ose dëshmi për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës 18.11.2022

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

